



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni vjeshtor

Nënkomisioni për Mandate, Imunitete dhe Rregullore të Kuvendit

Më 29.01.2013, në orën 11:00

Procesverbal

Në mbledhje morën pjesë: Armend Zemaj- kryetar, Albulena Haxhiu, Ardian Gjini, Gëzim Kelmendi dhe Mufera Şinik.

Nga Zyra mbështetëse: Fehmi Hyseni dhe Advie Morina.

Mbledhjen e kryesoi, Armend Zemaj, kryetar i Nënkomisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
3. Shqyrtimi i Projekt-raportit të punës së Nënkomisionit për Mandate, Imunitete dhe Rregullore të Kuvendit të Republikës së Kosovës;
4. Shqyrtimi i Planit të punës për vitin 2013;
5. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari konstatoi se Nënkomisioni miratoi rendin e ditës, pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar

Kryetari konstatoi se Nënkomisioni miratoi procesverbalin e mbledhjes së kaluar me vërejte.

3. Shqyrtimi i Projekt-raportit të punës së Nënkomisionit për Mandate, Imunitete dhe Rregullore të Kuvendit të Republikës së Kosovës

Armend Zemaj-kryetar, lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, vlerësoi Raportin e punës së Nënkomisionit për vitin 2012, si gjithëpërfshirës dhe të saktë për të gjitha aktivitetet që ka zhvilluar Nënkomisioni gjatë vitit 2012.

Gjithashtu, falënderoi të gjithë të pranishmit dhe vlerësoi lart kontributin e pamohueshëm në aspektin profesional, për përmbushjen me sukses të detyrave të planifikuara, duke u bazuar në Raportin e punës për vitin 2012.

Duke theksuar edhe angazhimin e të gjithë anëtarëve të Nënkomisionit, ai falënderoi për punën edhe deputetin Amir Ahmeti, i cili ka qenë i përkushtuar dhe ka dhënë kontribut të pamohueshëm, si dhe mbështetjen e OSBE-së me ekspertët e vet, NDI-në me ekspertët e vet, Kabineti i Kryetarit të Kuvendit me këshilltarët e vet.

Albulena Haxhiu, theksoi se raporti është real, por brengosëm për Rregulloren e punës së Kuvendit se çka është bërë dhe ku mbeti, ngase si anëtare e Nënkomisionit më intereson se kush po e pengon.

Armend Zemaj- Gjatë kësaj periudhe, Nënkomisioni ka përmbushur Raportin e punës për vitin 2012, gjegjësisht e ka përfunduar hartimin e Projektregullores së Kuvendit dhe e kemi proceduar për Kuvend. Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe, Nënkomisioni ka hartuar Ligjin për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit.

Nënkomisioni për Mandate, Imunitete dhe Rregullore të Kuvendit, në kuadër të fushëveprimit dhe përgjegjësi, i shqyrton të gjitha çështjet që ndërlidhen me zbatimin e Rregullores së Kuvendit.

Kryetari Zemaj, konstatoi se Projekt-raporti i punës së Nënkomisionit për vitin 2012, miratohet me disa vërejtje teknike, që administrata autorizohet t'i eliminojë.

4. Shqyrtimi i Planit të punës për vitin 2013

Nënkomisioni do të vazhdojë punën për hartimin e Ligjit për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit, duke u nisur nga vullneti i të gjithë anëtarëve të Nënkomisionit, në veçanti, ka mbështetjen e OSBE-së, NDI-së, Kabinetit të Kryetarit të Kuvendit me këshilltarët e vet, përfaqësuesit e OJQ-ve dhe Administratës së Kuvendit.

Në fund, Nënkomisioni nxori përfundim se në muajin shkurt ose mars, do mbahet një dëgjim publik, në të cilin do ftohen përfaqësuesit e Qeverisë së Republikës së Kosovës, Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Financave, Gjykatës Kushtetuese, shoqërisë civile, Asociacionit të Komunave etj.

Në fund, Nënkomisioni nxori përfundimin, si vijon:

Kryetari Zemaj- Konstatoi se Plani i punës së Nënkomisionit për vitin 2013, miratohet me disa plotësime teknike që administrata autorizohet t'i eliminojë.

5. Të ndryshme

Nënkomisioni u pajtua që data e mbajtjes së dëgjimit publik, të caktohet në ditët në vijim.

Kryetari kërkon nga shërbimi kompetent i Administratës së Kuvendit që t'i sigurojë të dhënat për ish-deputetët e tri legjislaturave të kaluara, si vijon:

Për ish- deputetët që tani kanë mbushur moshën (65 vjeç) e pensionimit, dhe ish- deputetët që brenda tri (3) viteve në vijim, do të mbushin moshën (65 vjeç) e pensionit.

Të dhënat shërbejnë për të llogaritur implikimet buxhetore, që do të pasojnë me zbatimin e Ligjit.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30.

Kryetari i Nënkomisionit

Armend Zemaj